



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 24/12/2025

Ora e hapjes së mbledhjes 11:00

Marrin pjesë:

1. z. Altin Habip
2. znj. Ada Përmeti
3. z. Petrika Tollkuçi
4. znj. Mirela Qeleshi

Marrin pjesë gjithashtu: Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Ana Verushi Kryetaja e keshillit
2. Eva Naci sekretare e keshillit

Nga ekzekutivi marrin pjesë: Valbona Ziko, Soniel Prifti, Denada Tabaku.

Kryesuesi i mbledhjes është Ada Përmeti.

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 4 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit**: Nuk ka

Pikat e rendit të ditës.

1. **Projekt-vendim (Pika 3 e rendit të ditës) 3- “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNOJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2026”** propozuar nga ekzekutivi.
2. **Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) 5- “PROJEKT BUXHETI I BASHKISË KORÇË I VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028.”** propozuar nga ekzekutivi.

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimet

U sqaruan nga përfaqësuesit e administratës nevojat për projekt vendimet. U sqaruan projekt vendimet nga ana e përfaqësuesve të administratës.

- Në lidhje me pikën 1, pagat janë propozuar në përputhje me VKM-në dhe për këtë vit nuk ka ndryshime. Janë të njëjtat paga si vitin 2025. I vetmi ndryshim është për pagën minimale e cila prej 1 janarit 2026 është në vlerën 50.000 në zbatim të VKM-së. Rreth 300 punënjës do të përfitojnë nga rritja e pagës minimale.
 - Për pikën 2 të rendit të ditës : Në buxhetin 2026, parashikohen burimet e financimit për shpenzimet e vitit 2026. Ka një rritje 6% krahasuar me vitin 2025.
- Burimet ;

- Të ardhurat.

- Transferta e pakushtëzuar.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale.
- Transfertat për rritjen e pagave.

1.239 punonjës do paguhet nga fondi prej 128.979.000 lek.

Ada Përmeti : Për investimet sipas programeve duhet të keni parasysh prioritetet e konsultuara nga ana e këshillit në takimet dhe konsultimet e buxhetit me Njësitë administrative. Propozimet dhe rekomandimet e komunitetit ja kemi percjelle Kryetarit të Bashkisë. Duhet të merren parasysh dhe ditën e mbledhjes do na informojë Kryetari sa nga rekomandimet janë marre parasysh. Gjithsesi, vlera prej 158.778 lek e parashikuar për investime është e konsiderueshme dhe ka rritje krahasuar me vitet e tjere por edhe në përqindje krahasuar me total shpenzimet.

Në lidhje me fondin për qentë endacakë u sqarua nga administrata se në vitin 2025 është përfunduar procedura për materiale dhe mjekime dhe këtë vit do bëhet vetëm prokurimi për steriulizimin dhe puna do realizohet nga punonjësit e bashkisë.

Mirela Qelesi : A janë bërë llogaritjet mbi bazën e popullsisë ? U sqarua se është bërë llogaritja mbi numrin e banorëve sipas Gjëndjes Civile.

Numri i punonjësve me kontratë të përkohëshme është 62.

Planifikimi i gjobave është konsideruar trendi i viteve të fundit.

Familjet planifikohen çdo vit nga administratorët e Njësive Administrative.

Tarifa e zënies së hapësirës publike llogaritjet mbi bazën e shfrytëzimit të sipërfaqes publike ditore.

Nuk ka objekte të Bashkisë të zëna ku nuk paguhet qera.

U kërkua evidencë e të ardhurave nga turizmi dhe administrata do pregatisë të dhënat dhe do ja dërgojë këshillit.

U kërkua dhe u dha informacion mbi numrin e bujtinave ku rezultoi se janë hapur këtë vit 7 bujtina të reja por nga ana tjetër ka ulje të numrit të dhomave pasi subjektet kanë ulur numrin e dhomave duke rritur cilësinë e akomodimit. Janë 34 dhoma më pak.

Në lidhje me tarifën e depozitimit të mbetjeve e cila është parashikuar në paketën fiskale u sqarua se llogaritja bëhet në momentin e zbardhjes së lejës së ndërtimit mbi volumin e gërmimeve.

Në lidhje me sasinë e karburantit u sqarua se llogaritja është bërë sipas normativave të aprovuara dhe numrit të mjeteve. Në mbledhje do informohen mbi të dhënat e detajuara.

Në lidhje me investimet sipas projekteve u sqarua se duhet të mbyllen thirrjet e hapura për financim ku Bashkia do jetë bashkëfinancuese dhe vetëm më pas do jenë të qarta për çdo

projekt të financuar. Këshilli i Bashkisë do të informohet për këtë proces dhe cdo projekt që do financohet.

Mbyllet diskutimi

Përgatitet Vendimi i mbledhjes së Komisionit që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Vendimi i komisionit u përgatit nga sekretari i Komisionit

Lexohet Projekt-Vendimi i Komisionit nga kryetari

- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 1 : PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.**
- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 2 : PRO 3, KUNDER 1, ABSTENIM 0.Miratohet.**

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes : 11 : 30.

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari i Komisionit

Sekretari i Komisionit



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. ____ datë. 24/12/2025

Nr. ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimeve, në lidhje me propozimin

- **Projekt-vendim (Pika 3 e rendit të ditës) 3-“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNOJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2026” propozuar nga ekzekutivi.**
- **Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) 5- “PROJEKT BUXHETI I BASHKISË KORÇË I VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028.” propozuar nga ekzekutivi.**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja) ligjit nr. 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe Në zbatim të ligjit nr. 9936 date 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 68 date 27.4.2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", Udhëzimit nr. 23 date 30. 7.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njesive të veteqeverisjes vendore", i ndryshuar, udhëzimit nr. 19 date 10.7.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevoja për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Për pikën 1: Vendim i përvitshëm miratuar njëherësh me buxhetin.

Për pikën 2: Kopetenca e këshillit për miratimin e buxhetit vjetor dhe PBA trevjeçare.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar apo nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Pika 1: Fondi është parashikuar në buxhetin e vitit 2026.

Për pikën 2 parashikon gjithë situatën financiare të Bashkisë Korçë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)

Kryetari i Bashkisë, Burimet njerëzore dhe Financat.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

Kryetari i Bashkisë, Burimet njerëzore dhe Financat. Raportimi sipas afateve ligjore

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Pika 1. Ka efekt tek punonjësit e Bashkisë Korçë.

Pika 2. Banorët e Bashkisë Korçë.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015?)

Po. Realizuar dhe marrë mendimet. Të dhëna të detajuara në regjistrin e konsultimeve publike.

Komisioni i Përhershëm për “Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare”, i mbledhur me datën 15/12/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

- 1. Projekt-vendim (Pika 3 e rendit të ditës) 3- “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNOJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2026” propozuar nga ekzekutivi.**
- 2. Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) 5- “PROJEKT BUXHETI I BASHKISË KORÇË I VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028.” propozuar nga ekzekutivi.**

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- T’i propozojë Këshillit Bashkiak, miratimin e projektakteve.

Argumentat e vendimmarrjes janë paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 24/12/2025